# A K T I

## I THEMELIMIT TE SHOQERISE SHQIPTARE "ORUÇI" ME QENDER NE KUKES.

Neni 1

Bazuar ne ligjin nr. 7638, date 10.11.1992 "Per shoqerite tregtare dhe ligjin nr.7667, date 28.1.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" perberja e shoqerise "ORUÇI" eshte si me poshte:

Gani Oruçi i biri i Rasimit dhe Rabies i vitlindjes 1970 lindur ne Nikoliq -Has e banues ne qytetin e Kuksit, me kombesi e shtetesi shqiptare.

Neni 2

Vendqendrimi i shoqerise do te jete ne qytetin e Kuksit, ne lagjen nr. 5 . Shoqeria do te hape dhe filiale si ne rrethe te tjera brenda vendit, ashtu dhe jashte, sipas mundesive e shtrirjes ekonomike te saj

Neni 3

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj 20 vjet. Permbajtja e aktit dhe kushtet e percaktuara ne te do te behen ne çdo rast me shkrim.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

ne fushen e eksportimit e te importimit te mallrave te gjitha llojeve, ne ndertimin e objekteve te ndryshem industrial, bujqesor, social kulturor, te ndertesave te banimit, ne transportin e mallrave e te udhetarve, veprimtari tregtare ndermjetesuese per te gjitha llojet e mallrave, ne veprimtari bankare.

Neni 5

Ne fillim te veprimtarise ekonomike e financiare shoqeria disponon nje kapital fillestar prej 100.000 lekesh te investuara nga ana ime ne masen 100 perqint.

Neni 6

Kapitali i shoqerise mund te rritet krahas rritjes se veprimtaris

./..

Gani Oruçi

te saj.Te ardhurat do te sigurohen nepermjet veprimtarise private, t percaktuar ne nenin 4 te kesaj kontrate.

Neni 7

Fitimet e realizuara ne veprimtarine private do te merren 100 pe qint nga themeluesi.

Neni 8

Themeluesi i shoqerise do te jete pergjegjes per çdo thyerje te rregullave ligjore, ekonomike e financiare gjate zhvillimit te aktivitetit te saj.

Neni 9

Akti i themelimit nenshkruhet nga themeluesi ne baze te statutit te nenshkruar prej tij per krijimin e shoqerise "ORUÇI"

Neni 10

Kembimi i monedhes kombetare shqiptare, lekut, me monedhe te huaj ose valute te huaj dhe anasjelltas do te behet ne perputhje me kursin zyrtar qe do te caktohet nga Banka e Shqiperise dhe nga bankat e tjera shteterore e private ose ne tregun e lire te valutes.

Neni 11

Maredheniet e punes te shoqerise rregullohen nepermjet kontrates dhe per çeshtjet qe nuk rregullohen me kontrate zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes.

Neni 12

Themeluesi ka per detyre te zbatoje rregullat e inspektoriateve te ndryshem si te atij financiar, higjeno-sanitar, te sigurimit teknik e

Neni 13

Kontrata e themelimit eshte e vlefshme per 20 vjet kohe e me te drejten e ripertritjes. Shoqeria do te pergjigjet me mjetet e saj pe detyrimet ndaj te treteve.

Neni 14

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin mes themeluesit dhe te trtete fizike apo juridike ose te marre ne pune simbas kontratës

./..

Gani Oruçi

trates se punes, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert ru-
het e drejta e zgjidhjes se mosmarrveshjes ne Gjykaten e Rrethit te
Kukesit, sipas statutit te shoqerise dhe kesaj kontrate si dhe kontra
tes se punes, do te zbatohen kerkesat e legjislacionit te punes te Re-
publikes se Shqiperise.

Neni 15

Themeluesi do ti jape prioritet punesimit te ish te perndjekurve po
litike, sipas nevojes qe do te kete shoqeria per pune dhe aftesive te
tyre ne bashkepunim me shoqaten e persekutuarve dhe te perndjekurve po
litike.

Neni 16

Kontrata hartohet ne tre kopje, ne gjuhe shqipe, e cila, pasi u le-
xua nga ana ime si themelues, nenshkruhet pa asnje verejtje.

Kontrata u nenshkrua sot me daten 13 shkurt 1995, ne Tirane.



T H E M E L U E S I

Gani Oruçi

# S T A T U T I

## SHOQERISE SHQIPTARE"ORUÇI" SH.P.K. ME SELI NE LAGJEN NR. 6 KUKES.

Muhamet Jaku veç aktit per themelimin e kesaj shqqerie, hartoi dhe nenshkroi dhe statutin e saj me kete perbajtje:

## KREU I PARE

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar"ORUÇI" me seli ne qytetin e Kukesit, ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te themeluesit dhe te punesuarve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise dhe çeshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Neni 2

Shoqeria sipas nenit 1 te ketij statuti, krijohet me mjetet vetiake te themeluesit Gani Oruçi me karakter prone private.

Neni 3

Shoqeria sipas nenit 1 e 2 te ketij statuti do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin shoqeria shqiptare"ORUÇI" SH.P.K..

Neni 4

Shoqeria ke statutin e personit juridik.

Neni 5

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Kukesit ne lagjen Nr. 5.

Neni 6

Shoqeria ka vulen e saj. Vula ka forme te rumbullaket, me madhesi te zakonsheme dhe rretheqark saj eshte shkruar teksti:

SHOQERIA"ORUÇI" SH.P.K;, ne mes shkruhet fjala Kukes dhe poshte saj SHQIPERI.

Nei 7

Objekti i veprimtarise private te shoqerise shqiptare "ORUÇI"

./..

Gani Oruçi

do te jete:

ne fushen e eksportimit e te importimit te gjitha llojeve te mallrave, ne ndertimin e objeketeve te ndryshem industrial, bujqesor, social-kulturor, te ndertesave te banimit, ne transportimin e mallrave e te udhetarve, ne veprimtari tregtare ndermjetesuese per gjitha llojet e mallrave dhe ne veprimtari bankare.

Neni 8

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj te percaktuar ne kete statut ne teritorin e Republikes se Shqiperise. Per kryerjen e kesaj veprimtarie, shoqeria mund te çele dege dhe zyrat e saj te perfaqsimit ne vend dhe jashte, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe legjislacionin e vendit ku çelen ato.

Neni 9

Shoqeria e kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin, duke u mbeshtetur ne parimin e likujditetit, sigurise dhe te rentabilitetit

Neni 10

Shoqeria ka pamvaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesia.

Neni 11

Themeluesi ka keto te drejta kryesore:

Te drejtoje veprimtarine e shoqerise ne perputhje me kontraten dhe me statutin, vete ose nepermjet perfaqsuesit.

Te posedoje e disponoje rezultatet e veprimtarise se shoqerise, te çdo gorme e sasie qofte ne perputhje me kontraten e statutin.

Te kete rolin e drejtuesit ne organet e shoqerise vete ose nepermje perfaqsuesit te tij.

Te disponoje ne çdo kohe te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese te shoqerise, si dhe te gjithe dokumentat e perpunuar si llogarite ekonomike, bilancet etj.

Ne çdo kohe kur e shikon me vend te informoje organet e shoqëris

./..

Gani Oruçi

KREU I DYTE
KUSHTET EKONOMIKE

Neni 12

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te parimeve te llogarise dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

Neni 13

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise caktohet nje kapita[l] themelor prej 100.000 lekesh. Kapitali themelor eshte vendosur 100 p[er]qint nga themeluesi. Shuma e kapitalit themelor depozitohet ne banke p[er] llogari te shoqerise. Per kete disponohet nje dokument ne te cilin ve[r]tetohet derdhja e tij.

Neni 14

Shoqeria ne emer te saj eshte pronare, perdoruese e pasurive te saj por gjithmone ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqeria mund te bleje pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci pasurite e saj per te marre kredi bankare.

Neni 15

Shoqeria krijon fondin rezerve ose dhe fonde te tjera te veçanta f[i]nancimi per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

Shoqeria i dispozon plotesisht mjetet e veta financiare.

Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbu lohen nga fonde rezerve, nga fonde te tjera, ose nga financime te bera nga te trete me miratimin ose kerkesen e themeluesit, ne rastet kur ke[to] detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

KREU I TRETE
ADMINISTRIMI

Neni 16

Organi vendimor i shoqerise eshte vete Themeluesi i cili gjate ushtr[i]mit te aktivitetit mund te krijoje dhe nje keshill konsultativ por ven[...]

./..

Gani Oruçi

-dos vete per te gjitha ceshtjet qe merr ne shqyrtim, si per bilancet mu-
jore, bilancet vjetore, ndryshimet ne statut, per shtimin e kapitalit
themelor, per emerimin e administratorve, per drejtoret e degeve e per
shkarkimin e tyre, per percaktimin e drejtimeve kryesore te veprimtarise
se shoqerise si dhe per shkrirjen ose mbylljen e saj.

Neni 17

Themeluesi ben mbledhje rregullisht ne çdo tre muaj, ne diten e fundit
te muajit te trete. Ne vendin te tij, me kerkesen e drejtoreve te degeve
ose te administratorit Themeluesi mund te zhvilloje mbledhje edhe jashte
radhe. Ne marrjen e vendimeve drejtoret e degeve etj ne raport me theme-
luesin kane te drejten e votes konsultative.

Neni 18

Ne mbledhjen e shoqerise ose ne konsultimet e saj me shkrim per çesh-
tje te caktuara, vendimet merren nga vete themeluesi.

Neni 19

Shoqeria "ORUÇI" Sh.P. administrohet nga administratori qe do te
jete perkatesisht z. G.Oruçi me cilesine e presidentit.

Administratori e perfaqson shoqerine kundrejt te treteve brenda caqeve
te veprimtarise se saj, si dhe kryen te gjitha veprimet e administrimit
ne interes te shoqerise.

Kompetencat ekskluzive te administratorit te shoqerise jane:

- Te miratoje planet e llogarite ekonomike, pas perpunimit te tyre,
ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise;

- Te beje ndryshimin kur lind nevoja te kapitalit themelor te Shoqeri-
se.

- Te hartoje e te miratoje akte normative, te percaktoje raportet ne
gjirin e shoqerise, duke perfshire dhe kuadrin e personelin;

- Te krijoje organet e tjera te domosdoshme per realizimin e objekt-
iveve te shoqerise;

- Te vendose per krijimin e njesive strukturore si filiale, dege e
perfaqesi ne qytete te tjera te vendit ose jashte shtetit;

- Te vendose per pushimin e veprimtarise se shoqerise

./..

Gami Oruçi

- Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit;

- Te ndjeke e te siguroje zbatimin e vendimeve te marra nga ana e tij

- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

Neni 20

Veprimtaria operative e shoqerise administrohet nga themeluesi z. Gami Oruçi ne cilesine e presidentit, i cili perben organin administrativ te shoqerise.

Themeluesi, ne kuadrin e kompetencave te tij, te percaktuara ne kete statut dhe ne vendimet e marra prej tij, vepron ne te gjithe sektoret, deget e filialet e shoqerise, per ndjekjen dhe realizimin e veprimtarise se percaktuar ne objektin e saj.

Themeluesi eshte drejtor i pergjithshem i shoqerise, i cili ka keto detyra kryesore:

- Organizon dhe kontrollon punen per zbatimin e detyrave qe rrjedhin nga planet ekonomike e financiare te shoqerise;

- Ndjek zbatimin konkret te vendimeve te marra nga ana e tij;

- Administron veprimtarine e filialeve, perfaqesive ose degeve;

- Perfaqeson shoqerine perpara te treteve ne gjykate, ne arbitrazh, ose ne organet e tjera shteterore;

- Nenshkruan kontrata ne emer dhe per llogari te shoqerise mbi bazen e interesave e te leverdise;

- Njeh kur e shikon te nevojshme te punesuarit ne rezultatet qe ka arritur shoqeria,

KREU I KATERT

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 21

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet per nje periudhe kohe prej 20 vjetesh te njepasnjeshem.

KREU I PESTE

MAREDHENIET E PUNES

./..

Gami Oruçi

Neni 22

Maredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionin shqiptar dhe kete statut.

Neni 23

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates individuale ose kolektive te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto çeshtje:

- Kushtet dhe menyra e marrjes ne pune;
- Fillimi i punes te punonjesit dhe caktimi i tij ne vendin e punes;
- Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor e te festave zyrtare;
- Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes;
- Pushimet dhe mungesat, te drejtat e detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes;
- Pushimi i maredhenies se punes;
- Paga e punonjesit per punen e kryer, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

KREU I GJASHTE

PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

Neni 24

Punonjesi eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e puneve dhe per zbatimin e detyrave me ndergjegje, ne menyre te ligjeshme dhe profesionale.

Neni 25

Drejtor i pergjithshem i pergjithshem i shoqerise shqiptare "ORUÇI" SH.P.K. eshte z. Gani Oruçi

Neni 26

Te ardhurat neto, mbas veçimit te fondeve te akumulimit administrohen nga vete drejtori i pergjithshem z. Gani Oruçi

./..

## KREU I SHTATE

## KREU I VEÇANTE

Neni 27

Nder qellimet kryesore te shoqerise shqiptare "ORUÇI" SH.P.K. eshte kryesisht ndihmesa e saj ne mekembjen ekonomike e financiare te vendit dhe ne veçanti per te kontribuar ne mekembjen ekonomike e financiare te shtreses se te perndjekurve politike e per krijimin e kushteve normale per ta.

Neni 28

Per kordinimin e aktivitetit te mesiperm ndermjet shoqerise "ORUÇI" SH.P.K. dhe shtreses se te perndjekurve politike drejtori i pergjithshem mban lidhje te drejteperdrejta ose cakton nje kordinator.

## KREU I TETE

## LIKUJDIMI

Neni 29

Veprimtaria e shoqerise perfundon ne kohen e caktuar ne kontraten e themelimit ose dhe me pare, kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshem veprimtaria e saj rezulton jo rentabel.

Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Neni 30

Kur shoqeria likujdohet Drejtori i Pergjithshem emeron komisionin e likujdimit, i cili paraqet per miratim bilancin e likujdimit te shoqerise. Shoqeria i jep fund veprimtarsie se saj ne çastin e miratimit te bilancit te likujdimit.

Neni 31

Mjetet financiare si dhe çdo pasuri tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise, kur shoqeria likujdohet, mbeten ne pronesi te themeluesit, mbasi te jene bere me pare pagesat per kreditoret.

Neni 32

Ky statut hartohet ne tre kopje dhe nenshkruhet rregullisht nga themeluesi i shoqerise sot me daten 13 shkurt 1995.

DREJTORI I PERGJITHSHEM

Gani Oruçi

(signature)